

VENDIM
Nr.296, datë 24.5.2006

PËR LEJIMIN E ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONIT (ERT) TË PËRDORË PROCEDURËN “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË”, PËR PAGESËN E KOSTOVE PËR NGRITJEN E SISTEMIT KOMBËTAR TË ADMINISTRIMIT TË SPEKTRIT TË RADIOFREKUENCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 17, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Entit Rregullator të Telekomunikacionit (ERT), që për fondin e vet limit prej 40 000 (dyzet mijë) USD, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me Byronë e Zhvillimit të Telekomunikacioneve (ITU, Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit), për pagesën e kostove për ngritjen e sistemit kombëtar të administrimit të spektrit të radiofrekuencave.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Enti Rregullator i Telekomunikacionit (ERT) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha